

VITI XVII, NUMRI 7/KORRIK

HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA

FOREVER




FAB
Forever
active boost
ZERO CALORIE
ENERGY DRINK
FOREVER
8.4 FL OZ (250 mL)
©2010 - 2013


FAB
Forever
active boost
NATURAL
ENERGY DRINK
FOREVER
8.4 FL OZ (250 mL)
©2010



CHAIRMAN'S BONUS

Mundësi të pashoqe nga Chairman's Bonus

Ishte një gjë e mrekullueshme të shikoje kaq shumë nga distributorët dhe bashkpunëtorët tanë më të mirë në Rally-in e Parë Global në Hawaii! Jemi krenarë, që në kuadrin e programit Chariman's Bonus, shpërndamë mbi 21 milion dollarë. Shtrohet pyetja: vallë cilat janë ato tipare karakteristike të përbashkëta për distributorët që kanë arritur këtë nivel? Të gjithë janë të motivuar, punojnë shumë duke ndjekur mundësitë për realizimin e objektivit të tyre.

Sikurse dëgjuam në leksionin frymëzues të Amy Purdy: „Përcakto objektivat dhe planet e tua”. Chairman's Bonus duhet parë si një plan konkret, që mund të arrihet në mënyra të ndryshme. Kurrë mos hiq nga sytë objektivin tënd, pavarësisht se në cilin stacion të udhëtimit forever je. Arritja e një plani të tillë serioz si Chairman's Bonus është shumë i rëndësishëm. Mos harro se rrethanat mund të ti ndryshojnë planet, dhe ndoshta duhen rimenduar, por arritja e pjesmarrjes në Chairman's Bonus dhe në Global Rally, duhet të mbetet gjithmonë si një objektiv konkret!

Pavarësisht se çfarë strategjie praktikon në ndërtimin e biznesit individual, sjellja dhe qëndrimi yt kanë shumë rëndësi. Ashtu si na mëson Gregg: kur flet për forcën FOREVER, gjithmonë buzëqesh! Megjithse distributorët pjesmarrës janë nga të gjitha anët e botës, ata prapë e kuptojnë njeri tjetrin, sepse buzëqeshja është një gjuhë e përbashkët. Kjo nuk ishte kurkund tjetër kaq e dukshme, sa në këtë Rally, ku festuam së bashku. Në qoftë se do të jesh gjithmonë i aftë të ndërtosh biznesin tënd duke buzëqeshur, me siguri vitin që vjen do të kesh arritur Chairman's Bonus-in.

Ishte një gjë e mrekullueshme, të shikoje se si të kualifikuarit për Chairman's Bonus që dilnin në skenë, nga sa shumë vetë të linjës poshtë tyre brohoriteshin. Kur kualifikohesh për Chairman's Bonus sjell shumë „ngazëllim” në linjën e poshtme, dhe i nxit që edhe ata të rrisin biznesin e tyre. Dikur autori Karen Jensen shkruan: “Ti mund ti numerosh farërat që ka një mollë, por ti nuk mund të numerosh kurrë sa mollë do të sjellë një farë e mbjellë. Kur ti mëson të tjerët, nuk mund ta dish se çfarë efekti do të kesh në jetën e tyre”. Chairman's Bonus është një program i tillë stimulues, ku bëhesh pjesë e atyre drejtuesve, që u jepet mundësia tu mësojnë të tjerëve strategjinë e tyre. Mos harro, se në qoftë se lufton për këtë objektiv, je një mësues, një shembull model për linjën poshtë teje.

Përgëzime të kualifikuarve për Chairman's Bonus të 2013! Vendosmëria dhe pasioni për sukses ishin evident edhe në Rally. Isha krenar që munda tju njoh e takoj në skenë. Këtu në Forever ne jemi kaq shumë me fat që jemi të rrethuar nga njerëz të motivuar dhe frymëzuar. Ju presim me kënaqsi në Rally-n e ardhshëm, në 2014 në Londër! Tani është koha ti buzëqeshim njeri tjetrit dhe në interes të suksesit të fokusohemi në mundësitë e ardhshme.

Ne jemi FOREVER!!

I juaji përjetë!
Rex Maughan

Vetëdija për misionin

Dy vjet më parë Aidan O'Hare zoti nën/president për Europën u drejtua me një kërkesë tek drejtorët vendorë të disa vendeve drejtuese për Europën, që në mënyrë të ngjashme me deklaratën e misionit të Home Office të përmbledhim në dhjetë-dymbëdhjetë fjali deklaratën tonë personale në këtë botë. E nisa atë, dhe fillova të numëroja ato gjëra, që janë të rëndësishme për mua si dhe për vetë ambientin tim më të afërt dhe më të largët. Pashë, që çfarë mund të bëj për to. U krijua një listë gjigande, nga e cila u kristalizua gradualisht edhe misioni im.

DEKLARATA E MISIONIT NGA DR. SÁNDOR MILESZ

Për të ofruar më të mirën si për vete edhe për të tjerët, jam vazhdimisht i vëmendshëm për atë, që çfarë presin prej meje. Nga dita në ditë kam nevojë për të gjithë forcat e mija, që të jem në formë të lartë. Duhet të kem kujdes, se çfarë ha, çfarë pi, mënyrën se si mendoj. Duhet të kujdesem për organizmin tim, sepse unë jam më i rëndësishmi për familjen time, për fëmijët e mi dhe për nënën time, sepse ata janë të dashurit e mi. Fëmijët e mi: janë e ardhmja ime.

E ndiej veten me fat, sepse jam njeri i lumtur. Çdo ditë i jam mirënjohës Rexit, i cili ndryshoi rrënjësisht dhe në drejtimin më të mirë të mundshëm jo vetëm jetën timë, por bëri të mundshëm një mirëqënie të lartë edhe për fëmijët e mi.

Vazhdimisht zgjeroj njohuritë e mija. Lexoj libra dhe shfletoj faqe të vlefshme nga interneti, që të kem një kulturë sa më të madhe. Në jetën time një vend të lartë zënë sporti, muzika, fotografimi dhe arti në përgjithësi.

Jam gati për atë, që miqtë, kolegët, partnerët e mi ti shoqëroj deri në fund në rrugën drejt ëndrrave më të guximshme. Duhet ti mësoj njerëzit, se si të sillen me paranë.

Më pëlqen t'ju dhuroj të tjerëve, sepse ajo më bën të lumtur dhe më mbush me kënaqësi.

Më pëlqen të shikoj rreth vetes fytyra të lumtura, në veçanti fëmijë të buzëqeshur. Kjo është jeta ime. Jeta është shumë e shkurtër, që ta shpërdorojmë, prandaj nuk e shijoj atë 100% por 1000%.

Jam një biznesmen i suksesshëm 53-vjeçar. Jetoj në harmoni. Zoti më do mua dhe unë e dua Atë.

Përpara FLP Albania!

Dr. Sándor Milesz
Drejtor i Përgjithshëm



BERKICS MIKLÓS FOREVER DIAMOND TRAINING

BUDAPEST 8-9 QERSHOR, 2013.



Në fillim të verës u organizua për herë të dytë po me të njëjtin sukses në Budapest, në Sallën Syma, Trainimi në kujdesin e Diamant menaxherit Miklós Berkics. Mbajtën këtu leksione më të mirët , jo vetëm të rajonit, por edhe emra të dëgjuar në nivel botëror. Drejtor i përgjithshëm për Hungarinë dhe rajonin sllavo jugor, Dr Sándor Milesz, si dhe diamant menaxheri Miklós Berkics udhëhoqën programin e ditës.



KATI GIDÓFALVI – DIAMANT MENAXHERE

„Bota e diamantit të Foreverit, është diamanti më i ndritshëm, mund të të motivojë në mënyrë të shkëlqyer për të sponsorizuar” i thotë drejtori Dr Sándor Milesz Kati Gidófalvi-t. Ajo vetë flet në mënyrë modeste „Rrjedhim nga një familje e thjeshtë, e kemi nisur nga një jetë pa një shtëpi tonën, por në një dhomë e guzhinë, me një makinë të vjetër 16 vjeçare...shumë donim ti arrinim nga prindërit, kështu filluam në këtë botë.”Atilla dhe Kati Gidófalvi gjithmonë e 20% punë, sjell 80% të rezultatit. „Është shumë e pabesueshme, që nga 10 vetë që do të takosh, 8 vetë nuk lidhen me ty. Por besojeni se ka rregulla, ka ligjshmëri: gjërat funksionojnë. Puna e përditshme me hapa të vogla sjell rezultatin, mjafton që të gjesh njerzit e duhur. Detyra jonë nuk është të flasin vetë, drejt bashkpunëtorëve tanë duhet tu përcjellim që ky është një biznes i mirë për ta, mbasi njerzve ju intereson se çfarë do të përfitojnë prej tij. ndërsa ne sa më shumë të njohim nevojat e tjetrit, aq më të fortë bëhemi. Për këtë biznes nuk duhen aftësi apo talent i veçantë, por më shumë endërra për të të lëvizur nga ajo që të rrethon. Njeriun e sukseshë nga të pa sukseshmit nuk e dallon ajo që është me fat, por ajo që shikon se nga kush mëson. Sipas Katit, biznesi i sukseshëm ka një „nënprodukt” të mirë, ai është efekti forcues i mardhënieve: „la vlen që si çift, objektivat e përbashkëta ti realizoni bashkërisht.”



DR. EDIT RÉVÉSZ SIKLÓSNÉ - SOARING MENAXHERE

Në leksionin e fillimit mund të mësojmë nga burimet më të mira të mundshme se cilat janë produktet e Foreverit, me të rejtat më të fundit. Dr Edit Révész Siklósné – kryetare e Komitetit të Mjekëve Profesionistë na flet për trendin e zhvillimeve të reja të nivelit botëror, për koleksionin Sonya si dhe për pijen më të re energjike pa kalori si dhe për ato produkte bazë të cilave ju është ndryshuar përmbajtja ose mënyra e paketimit sipas rekomandimeve të mjekëve. Dëgjojmë gjithashtu për pasojat e mungesës të vitaminave dhe lëndëve minerale që janë karakteristike për popullsinë hungareze si cilat janë mundësitë tona për marrjen e sasisë ditore të rekomanduar. Dihet se sa pak fruta dhe zarzavate konsumojnë çdo ditë nga 5-9 racione që figurojnë rekomandime. Shumica „janë tepër të ngopur, por të paushqyer” thekson Dr Edit Révész Siklósné. Por është një lajm i mirë që 64 % e burave dhe 74 % e grave përdorin një plotësues dietik, ndërsa është një e dhënë bindëse që 96% e dietistëve praktikojnë këtë zgjidhje. „Ka rëndësi që të plotësojmë lëndët ushqyese, ndryshe do të kemi një shëndet të dobët” – shpjegon specialistja. „Shëndeti optimal, fillon në nivelin e qelizave, dhe atje duhet të mbrijnë lëndët ushqyese, sepse ata pjesëza përbëjnë bazën e organizmit të shëndetshëm.”





SCHAFFER BODO AUTOR, KONSULENT BIZNESI, TRAINUES

„E keni provuar ndjenjën , kur keni rezultate, por nuk keni vlerësim? Vetëm ti mund ta ndryshosh këtë” Sipas Schaffer Bodo, rritja e personalitetit nuk është rrugë e shkurtër, por ia vlen mundimin.: sa më shumë informacion të kesh, nga një këndvështrim i ri do ta shikosh botën. Detyra primare është krijimi i një vizioni të ri. Në kë mund të ecësh vetëm si nivel, mbasi në këtë kohë, „endërrat i presim sipas personalitetit” – thekson trainuesi. „Harrojini bestytnitë, që ju kufizojnë! Nuk luan për humbje, por për fitore, merr sa më shumë është e mundur nga jeta, sepse është shumë e shkurtër, që të mos e konsiderojmë të rëndësishme. Problemet në vetvete nuk janë të këqija, sepse ka rëndësi që të ketë sfida të tilla, me të cilat duhet të ballafaqohesh. Problemet kurrë nuk janë shumë të mëdha, por ne jemi tepër të vegjël. Çështja shtrohet: çfarë njeriu njeriu duhet të bëhesh që të realizosh endërrat e tua, sepse biznesi vërtet i mirë nuk flet kurrë për produktet por për njerzit.” Schaffer Bodo, kërkon që të vendosim , sa do të donim të fitonim pas 3 vjetësh. Ta përpilojmë në mënyrë precize dhe ti premtojmë vetes se do tia arrijmë. „Kur premton diçka, hyn në fuqi ligji i gravitetit, dhe ky funksionon gjithnjë. Në qoftë se pengohesh, mbyll sytë, dëgjo jehonën , dhe do ta gjesh rrugdaljen! Bëjeni veprën e jetës tuaj kryevepër, të jeni krenarë për vetveten!”





ATTILA GIDÓFALVI – DIAMANT MENAXHER

Çifti Gidófalvi nisi këtë biznes në 2008 të sponsorizuar nga Miklós Berkics. Mbas 39 ditësh u bënë menaxherë, mbas 4 muajsh soaring menaxherë, mbas 1 viti diamant-zafir menaxher, ndërsa mbas 1 vit e gjysëm diamant menaxherë, duke fituar kështu titullin „distributorët më të mirë të botës“.

„Sekreti është ligji i gravitetit: nuk duhet menduar por duhet vepruar. Jo të dish, por të besosh: ky është pasioni i jetës. Duhet sponsorizuar aq njerëz sa ke takuar. Jo me fjalë, por me shpirt. Të ardhmen duhet ta përjetosh, sikur po ndodh tani.“


Attila një pjesë të mirë të fjalës së tij ia kushton mardhëniet midis sponsorit dhe të sponsorizuarit, na tregon se si njerzit që ndryshojnë nga personaliteti plotësojnë njeri tjetrin. „Dua që sponsori im të jetë krenar për mua, dhe të fitojë shumë para, sepse i meriton. Nga sponsori im unë kam mësuar, se nuk duhet tu tregohesh të tjerëve se kush je. Edhe suksesin duhet ta mbash me autoritet!“

„Ne nuk jemi forevera vetëm këtu në këtë sallë, gjithkund duhet të perfaqsojmë këtë firmë. Unë gjithmonë jam diamant, të paktën këtë kërkoj. Mbase nuk vlen asgjë një distiktiv, në qoftë se pas tij nuk je po ai njeri, ky do të jetë shembulli për të tjerët. Dua të bëhesh dikushi dhe jo ai që ke diçka! Bëhu njeri i tillë, me të cilin njerzit duan përzëmërsisht të lidhen, por mos harro: vetëm me atë mund të punosh, që e do edhe ti. Nuk mund të arrish të bëhesh i sukseshëm me këdo!“

Attila Gidófalvi si përshëndetje mbyllëse citon një mësim të Arnold Schwarzenegger : „Përqafo rregullat, mos dëgjo ata që të duan të keqen, përpuno veten, ki besim tek vetja, mos ki frikë nga falimenti dhe ktheji diçka publikut!“

Përmbledhjen e ditës së dytë të Trainimit të diamantëve do ta lexoni në revistën tonë të muajit Gusht

**Në Trainimin e
Diamantëve që
do të zhvillohet
në Tetor një nga
lektorët e huaj të
ftuar do të jetë
Allan Pease. Ja disa
pjesëza nga biseda
me të dhe me
bashkshorten e tij
Barbara.**



ALLAN PEASE
AUTOR LIBRASH, LEKTOR

ARTI I TË KOMUNIKUARIT

KONTROLLOJE EGON TËNDE NË DERË!

Shumicën e çifteve i dëmton lufta për pushtet, por tek çifti Pease kjo qëndron ndryshe. „Tek ne nuk ka të tillë luftë, unë bëj ç’të dua dhe Allan bën ç’të dojë. U desh ca kohë që të arrihej kjo, por kjo ishte një pjesë kritike e punës sonë” – thotë Barbara. Natyrisht kur jemi bashkë në skenë ndonjëhere ndodh edhe me ne që të ndeshemi me njeri tjetrin. „Kur ai ndodhet në skenë dhe 25 mijë vetë thonë: sa fantastik, atëhere nuk mendoj se duhet të isha unë atje, por më shumë më bën përshtypje dhe krenohem për të” – thotë zonja.

„Merita 50% është asaja!” – thekson Allan duke qeshur.

Të dy shkëmbejnë rolet me njeri tjetrin. Sipas tyre, një nga gjërat më të rëndësishme në këtë biznes është besimi, kështu ai bëhet një sipërmarrje e rëndësishme dhe pa ego. E ndjejmë veten shumë mirë në atë, për atë dhe ashtu siç e bëjmë” – vren Allan. „Ne jemi tifozyt më të mëdhenj të njeri tjetrit.”

VENDIMET E RËNDËSISHME MERRINI GJITHMONË SË BASHKU!

Kur punon bashkë me partnerin tënd në një biznes (pavarësisht, në se jeni bashkëshortë ose jo) vendimet nuk duhet marrë vetëm. Një gjë duhet kuptuar në vendimet më të rëndësishme. „Në qoftë se unë vendos diçka, dhe Allan-it i duket se unë po përpiqem ta orientoj atë në drejtim tjetër, atëhere kjo nuk sjell ndonjë gjë të mirë ...” – mendon Barbara.

Ndërsa gjëja e mirë, është ajo që në familjen Pease, rrallë ka kontradikta. Po kështu ka edhe një strategji të thjeshtë që duhet unifikuar: „Në qoftë se për diçka nuk biem dakort, le të përshkruajmë argumentat dhe kundër argumentat. Në qoftë se krijohet një gjendje si pati në shah, atëhere shtyjmë marrjen e vendimit, dhe për këtë biem dakort se ka nevojë për më shumë kohë për të vendosur” – thotë Barbara.

BËJE ÇËSHTJE FAMILJARE!

Çdo lektor apo shkrimtar do të mund të bashkpunonte me partnerin e tij, qoftë bashkshort, bashkshorte, apo shok bashkjetese, por nuk është kështu. „Në biznes, shumë mund të të ndihmojë familja jote – mendon Allan i cili, deri tani ka shkuar në 66 vende të botës bashkë me bashkëshorten e tij. „Nuk ka arsye që mund të justifikohet, që bashkshorti ose bashkshortja të mos vijë me ty. „Kur të dy punojnë së bashku në biznes krijohet një mjedis pozitiv, dhe për fëmijët një mundësi e mirë të mësuari”

„Buzëqeshja është pjesë e domosdoshme e bisedës, që dërgon sinjale të tilla në tru, që tregon se bashkëbiseduesi nuk është i rrezikshëm dhe nuk përbën kurrfarë kërcënimi.”

Çifti Allan ka 6 fëmijë dhe 9 nipër e mbesa. Djali ynë 8 vjeç, Brandoni, tashmë ka qënë në 42 vende. Bella, më e vogla, është 5 vjeçe, tashmë që të dy, do të zgjerojnë pak biznesin familjar. Kuptojnë thelbin e shkëmbimit të valutave, blerjen me kartë krediti, dhe kanë mësuar shprehjet bazë të dhjetë gjuhëve të huaja, si psh „të lutem, tingjatjeta, ju faleminderit. barbara tashmë ka qënë prezent në një leksion të Brandonit. „Në qoftë se Allan ka ndonjë problem, atëhere dërgon djalin që të mbajë leksionit” – thotë ajo duke qeshur. „Brandon, tashmë e di ndryshimin ndërmjet komunikimit me gratë dhe komunikimit me burrat. E ka bërë zakon të lexojë librat tona.”

Ndoshta më e rëndësishmja është ajo që njerzve nuk u mësojmë mënyrën e të biseduarit, por mënyrën si ti duan njerzit.

„Jam shumë i lumtur me jetën time dhe e kënaqur me atë që bëj” – thotë Barbara.

E vetmja mungesë e gjithë kësaj është bukuria femërore: „Nuk arrij të përqëndrohem” (Allan qesh me të madhe). Por ata partnerë, që arrijnë të punojnë së bashku, gjithmonë rezultati që ata arrijnë ia vlen.

„Të flasësh për biznesin, ka qënë gjithmonë një gjë e mirë” – thekson Allan. Por sigurisht kur për të ke gjetur recetën e duhur.”

FOREVER

DITA E SHËNDETT NË SHIFRA:

- 43 eksponante
- 18 leksione profesionale në 360 minuta
- më tepër se 2000 të vizituar
- 2920 vetë morën pjesë në kuadrin e këtyre analizave
- në kontrollin mjekësor morën pjesë 74% gra dhe, 24% burra
- të dy grupet treguan vlera mesatare mbi peshe, përmbajtje të lartë dhjamrash në trup dhe masë muskujsh mesatare.
- për të dy sekset ishte karakteristike niveli relativisht i lartë i stresit biologjik
- rreth tre çereku tyre vuan nga ndonjë problem i peshës mbi tabarin e këmbës

Vazhdon përmbledhja e filluar në numerin e kaluar të revistës, për Ditën e IV-të të Shëndetit.



Ferencné Tanács, mjeke natyraliste, senior menaxhere, që nga fillimi i punës të saj ka qënë e dhënë pas mënyrave alternative të kurimit dhe tek parandalimi i sëmundjeve. Ajo tërheq vemendjen lidhur me mënyrën e jetesës dhe për rëndësinë e mardhënieve bashkshortore: përvoja tregon se njerzit e nervozuar me njeri tjetrin flasin pak. Në klinikën e tyre të mjekësisë alternative, shumë here mjafton ti dëgjosh pacientët, dhe me atë i ndihmon shumë. Sëmundjet shpirtërore, apo sëmundjet që kanë të bëjnë me varësinë nga veset si "pirja e duhanit", kërkojnë që të kenë vullnet që ti lënë këto vese.



Dita e IV-të e Shëndetit



Erika Davis fizioterapiste, senior menaxhere, ka një përvojë 30 vjeçare në trajtimin e problemeve të shtyllës kurrizore. Në leksionin e vet ajo thekson rëndësinë gjimnastikës sistematike. Mbyllja në shtëpi dhe detyrat ditore nuk kompensojnë sportin, mbasi gjatë ushtrimit sportive kyçet lëvizin më shumë, muskujt kryejnë punë, dhe rritet numeri i rrahjeve të pulsit. Erika u bën thirrje atyre që e dëgjojnë, që tashmë të fillojnë një lloj gjimnastike, duke mbajtur parasysh rritjen e saj.



Dr. István Taraczközi, kryetar i Shoqatës të Mjekësisë Alternative Hungareze, në temën e tij me titull "Kuroje veten nëpërmjet ushqimit" na flet për konceptet tibetiane për sëmundjet. Ata i kërkojnë shkaqet e sëmundjes tek ushqimet, tek ndryshimet e stinëve të vitit, tek mënyra e jetesës dhe tek problemet karmikus. Pra çështja e pare e kurimit ishte ndryshimi i dietës. Ekzistojnë një numer i pafund sistemesh ushqyerje, ku cila është më e përshtatshme, atë duhet ta vendosë individi, në bazë të përvojës personale. Megjithatë sëmundjet mund të jenë të ngjashme, terapitë duhet të jepen sipas individit.



Dr. Ottó Kertész veteriner, menaxher, jep këshilla atyre që mbajnë kafshë shtëpiake, duke bërë një kalim imagjinar nëpër sistemin tretës të një qeni, që nga zgavra e gojës deri tek zorra e jashtëqitjes. Një sërë problemesh mund të lindin në kanalën e të ushqyerit, të cilat Ottó në praktikën e tij 30 vjeçare i ka ndeshur shumë here. Ndoshta edhe për këtë, për zgjidhjen e tyre kaloi tek zgjidhjet alternative.



Erika Fodor mjeke alternative, trajnuese pë jogën, na prezanton pesë praktika të jogës, të cilat mund të ndihmojnë në ruajtjen e shëndetit. Në fillim kjo praktikë për këdo mund të provohet tre here, pastaj me rutinën e duhur mund të përsëritet edhe njëzet e një here.

Dr. Endre Seres – kirurg, zafir menaxher, ndërmjet sfidave që përballon bota sot, përmend mjedisin, ndotjen e ajrit dhe ndryshimet në ushqimet që përdorim sot, duke theksuar se duhet të fitojmë betejën kundrejt efekteve mjedisore negative. Edhe ai ka qënë skeptik për plotësuesit dietikë, por tani përvoja e ka bindur se ka ardhur koha ti kthehemi natyrës.



Në ditën e Shëndetit u prezantua show spektakolar me familjen e produkteve krejt të reja të kozmetikës zbukuruese **"Flawless by Sonya"** që me vajzat modele me fundet me thekë dhe të zbukuruara me fondatinat, të kuqhtë e buzëve apo pudrat e syve sjellin frymën e Hawaii-t.





Dr Ilona Juronics Vargáné pediatre, soaring menaxhere, si temë të leksionit të saj ka zgjedhur mbrojtjen e fëmijve nga sëmundjet. Në fillim të karrierës së saj habitej në qoftë se ndeshte një fëmi me azmë, kurse sot mbas 30 vjetësh në çdo 3 pacientë fëmij, njeri paraqitet në ambulance me këtë sëmundje. Dy mungesa kanë sot fëmijët: ushqimin trupor dhe shpirtëror, dhe të dyja mund tua japim ne prindërit. Ushqimi shpirtëror rrjedh nga dashuria dhe përkujdesja. Ushqimet cilësore, me lëndë ushqyese me vlerë dhe me lëndë minerale janë shumë të rëndësishme për çdo moshë, por në mënyrë të veçantë në periudhën e rritjes.



Dr. Mária Anna Nagy farmacistë, ka si temë të sajën homeopatinë për arritjen e shëndetit, bukurisë, dhe harmonisë. Se çfarë dëshirojmë dhe çfarë mendimesh kemi kjo varet nga ne. Maria rreshton praktika të prekëshme për arritjen e harmonisë: fjetja herët dhe në mënyrë të rregullt, pirja e lëngjeve të duhura, ecja zbathur në natyrë, përtpjja e mire e ushqimeve. "Të vendosim çfarë është më e rëndësishme për ne dhe asaj ti kushtojmë kohën dhe energjitë tona!" – na thotë ajo



Attila Király dhe Lilla Timár Királyné, mmenaxherë, na zbërthejnë idetë e organizatës botërore të shëndetsisë (WHO) për ruajtjen e shëndetit në familje. Për arritjen e shëndetit shpirtëror, një mundësi e shkëlqyer është ndërtimi i rrjeteve, mbasi është një faktor që rrit vetbesimin dhe vetrespektin për arritjen e suksesit. Shembullin e prindërve e ndjekin edhe fëmijët, mbasi është e rëndësishme që të të shikojnë një shembull pozitiv, sepse duhet larguar mungesa e besimit në vetvete që është karakteristike tek fëmijët e sotëm. Mirëqënien sociale e përcakton koha e kaluar në mënyrë cilësore me familjen, që tashmë edhe familja nga Pecs, tre vjet mbas lidhjes me Foreverin, bëjnë atë jetën familjare që kishin endërruar kur ishin të rinj.

*Dita e Shëndetit do të organizohet përsëri në Maj 2014!
Ekspozantet mund të regjistrohen që tani!*

Tashmë për të tridhjet e gjashtin vit, Foreveri çdo ditë na përforcon bindjen se jemi në vendin më të mirë. Rex Maughan, themeluesi dhe pronari i firmës, presidenti Gregg Maughan, zëvendës presidenti i FLP për Europën, Aidan O'Hare, si dhe i gjithë stafi i drejtorisë, bashkë me drejtorët rajonalë dhe kanë punuar me angazhim e vetëdije për misionin e tyre, që gjithmonë të jemi ndërmjet më të mirëve dhe vazhdimisht të shkëlqyer.



FOREVER
DIRECT

Dhe ska si të jetë ndryshe. Mbas 5 vjetëve punë të suksesshme, Magazina Qëndrore e Distribucionit për Europën „Forever Direct“, u çvendos në një godinë të re dhe më të madhe. Si një anije flamurtare e Forever Living Products me sipërfaqen e saj prej 18.000 m², tani ajo përbën një bazë furnizimin për 95 vende të Europës dhe Afrikës.

Vendosja e saj është e përsosur, afër porteve, aeroporteve dhe autostradave me rëndësi strategjike. Përveç si qendër për furnizimin e vendeve të Europës dhe të Afrikës, tashmë ajo do të shërbejë edhe si një qendër e shitjes direkte të produkteve.

Hapja ceremoniale u bë më 17 Maj 2013, ku drejtues i programit ishte Drejtori i Menaxhimit të „Forever Direct“, Martin Zegers. Për rëndësinë e aktivitetit flet edhe ajo që në të ishin prezent gati i gjithë stafi drejtues i Foreverit, ku me kënaqsi dhe krenari shprehën falnderimin e tyre, themeluesi dhe pronari i firmës Rex Maughan, presidenti Gregg Maughan, Garin Breinholt, Gary Shreeve dhe Aidan O'Hare (përkatesisht zëvendës presidenta për Amerikën e Jugut, Afrikën dhe Europën). Pjesmarrësit dëgjuan paraprakisht leksionet e Navaz Ghaswala (Zëvendës presidente e përgjithshme) dhe të Steve Hatchett (Drejtor i Aloe Vera of Amerika). Ndërsa Rex Maughan dhe Gregg Maughan folën plotë forcë, energji dhe entuzizëm për aktivitetin e firmës, për fillimet dhe periudhën që parapriu hapjen e qendrës „Forever Direct“.

Një firmë MLM e bëjnë të madhe, drejtuesit, produktet dhe plani i marketingut, prandaj edhe Foreveri është ngritur lart mbi firma të tjera, sepse këto i ka të gjitha të shkëlqyera, por janë edhe bashkpunëtorët distributorë që Foreverin e bëjnë vërtet të madhe.

I dërguari i ambasadës amerikane, i ngarkuari lokal i Dhomës të Tregëtisë Amerikane (AmCham) dhe Kryetari i Bashkisë përshëndetën aktivitetin me fjalët më të mira, shprehë falnderimin e tyre për bashkëpunimin dhe theksuan forcën dhe rëndësinë e prezencës ekonomike amerikane dhe europiane në Europë si dhe treguan sa faktor i rëndësishëm lëvizës ekonomik është Foreveri edhe në kontinentin tonë. Në aktivitet ishin gjithashtu prezent një numer partnerësh, miqsh dhe përfaqësues të shtypit. Të nesërmen në kuadrin e një Dite Suksesi historike u bë hapja për publikun. Takimi u organizua në sallonin e distribucionit, të përshtatur me një skenë dhe sallën e spektatorëve, të kompletuar me bokset zanore dhe teknikën tjetër, zunë vend 2500 distributorë, që kishin ardhur nga të gjitha anët e Europës. Baza e fuqishme e magazinave dhe e zyrave, që u përgjigjen standarteve amerikane dhe europiane, të kompletuara me zhvillimet teknike më moderne, duke patur parasysh jo vetëm kërkesat profesionale, praktike, por edhe ato estetik eme dizajne të brëndshme të veçanta sipas shijes të Foreverit. Kompleksi është një kryevepër, që i përgjigjet nivelit dhe kërkesave të bashkpunëtorëve dhe përforcon ndjenjat që burojnë prej tyre se këtu jemi në vendin e duhur.

eat your
masterpiece,
create Greatness!

Rex Maughan
18 MAY 2013





- FOREVER
- Sipërfaqja totale e kompleksit është 18.000 m², nga kjo 1.000 m² janë zënë nga godina 3 katëshe e zyrave. Sipërfaqja prej 17.000 m² e teritorit të magazinave është rreth 2 herë më e madhe se sipërfaqja e stadiumit olimpik të Athinës.
 - Nga magazinat „Forever Direct” bëhet furnizimi i 95 vendeve të Europës, Afrikës dhe ish Bashkimit Sovjetik.
 - Forever Direct pret çdo vit 1.000 ngarkesa, kryesisht konteinerë. Ngarkesat që vijnë në qendër udhëtojnë nga Amerika për 17 ditë nëpër oqean.
 - Nëpërmjet 16 portave logjistike, bëhet pritja dhe nisja e dërgesave.
 - Malli i ardhur brënda 5 orëve bëhet gati për tu rinisur në destinacione.
 - Janë në dispozicion rreth 8.500 vende vendosje malli, që në rast nevojë mund të zgjerohen deri në 10.000.
 - Në magazinë është llogaritur trajtimi dhe etiketimi automatik dhe gjysëm automatik.
 - Çdo ditë mund të përgatiten deri në 7.000 pako me produkte
 - Dërgimi pakove bëhet 99.9 % brënda kohës së caktuar.
 - Transporti mund të bëhet me anije, me kamiona dhe me mjete hekurudhore.



Falnderojmë për magazinat e reja „Forever Direct” që krijojnë një mundësi të re për biznesin e Foreverit. Përpara Forevere!

Zsuzsa Lenkey - menaxhere





„FALEMINDERIT SE PËRFITOVA SHUMË”

FALË PLANITË SHKËLQYERTË MARKETINGUTTË FOREVER LIVING PRODUCTS, ÇDO VIT DALIN SFIDATË REJAQËIA VLEN TË REALIZOSH. EDHE MË PARËNË SI PËRMARRJETEMI AKAMPUNUAR FORT PËRGJITHSHKA, POR NJË VLERËSIM TË TILLË, SI KY QË PROVOVA KËTË VIT NË FOREVER NUK KISHA PATUR KURRË.



MOS HARRONI!

*Eagle Manager Retreat i
ardhshëm do të jetë nga 24-
29 Shtator 2014 në Lake
Tahoe, Nevada, SHBA*

Bashkë me disa rjetndërtues të shkëlqyer hungarezë munda të bëhem pjesmarrës dhe të përfaqsohem në Takimin e Parë të Menaxherëve „Eagle” në Sardenjë. Ishte një nder i madh të merrje pjesë në këtë takim ndërkombtar me drejtues të tillë për të cilët edhe deri tani kisha parë dhe mësuar prej tyre. Qysh në aeroport, ku e takuam me menaxherët e tjerë „Eagle”, u ndie atmosfera e jetës në Forever. Péter Lenkey, drejtor i menaxhimit të firmës sonë na takoi në aeroportin e Budapestit grupin tonë të vogël. Gjatë tranzitit në aeroportin e Romës u takuam me një pjesë të skuadrës të Kazakistanit. U gëzuam shumë dhe filluam të bënim foto me ta, që këtu atmosfera arriti kulmin. Ishte një ndjenjë e veçantë që të takoheshe në një vend të huaj me njerëz të tillë, që përfaqsojnë ndjenjat e të jetuarit në Forever. Prej këtij udhëtiam për në ishullin e Sardenjës, në qytetin e Cagliari, ku me autobus na çuan në hotelin me 5 yje Forte Village. Në hotel tashmë na prisnin fytyra të njohura duke na përshëndetur me një gotë pije. Pas zënies të dhomave, pamë mundësitë e ofruara nga ky hotel. Para nesh hapej një mjedis i mrekullueshëm, një pamje vërtet prrallore. Papagajt dhe flamingot rrinin lirshëm në këto mjedise: sikur të kishin rënë në pyllin e lashtë të tyre. Pamë pishinat, qendrat sportive, bregun e plazhit dhe gjithë resorantet. Këtu u takuam dhe u njohëm edhe me grupet e ardhur nga vendet e tjera. Pas darke kaluam një mbrëmje shumë të ngrohtë me grupin slovak. Të nesërmen filloi trainimi, që na dha shumë të gjithëve. Që në mëngjes na prisnin tek porta Rex dhe Gregg Maughan si dhe Aidan O’Hare. U gëzuam, përqafluam njeri tjetrin, shkëmbyen biseda të shkurtëra dhe bënë foto me ne. Ishte kënaqsi e veçantë ti takoje nga afër! Isha i lumtur që munda të jem pjesë e një grupi të tillë miqsh të ngushtë të Foreverit. Katër vjet më parë, kur fillova të ndërtoj biznesin tim, pikërisht këto gjera më motivuan.

Lenkey, drejtor i

Miklós Berkics dhe Attila Gidófalvi, anëtar të Global Leadership Team na pritën ngrohtë dhe na ndihmuan për gjithshka. Ditën e parë të trainimit rjetndërtues të shkëlqyer, menaxherë diamantë na folën për përvojën e tyre duke na dhënë një informacion shumë të rëndësishëm. Dita e parë u mbyll me bisedën e Gregg, për të cilën besoj se pati ndikim në zemrën e gjithkujt. Edhe programet e lira ishin të mrekullueshme, ku secili mund të përzgjidhte sipas qejfit. Ndërsa në mbremje kishim darkë argëtimi! Ditën e dytë të qënien tonë këtu e kurorëzoi trainimi. Rex i bëri takimit një mbyllje të tillë, që gjithkujt i la një përshtypje fantastike. Mbasdite morëm pjesë në një trainim të mbyllur të drejtuar nga Attila dhe Miklós. Mësuam shumë dhe përvoja jonë gjatë këtyre pak ditëve do të kishte qënë e varfër, në qoftë se nuk do të kishim dëgjuar leksionet e diamant menaxherëve. Darka ceremoniale e mbylljes u zhvillua pranë bregut ranor. FLP sivjet festoi 35 vjetorin, prandaj dhe patëm një tortë të mrekullueshme me disa kate, që u pasua me fishekzjarre sensacionalë. Ndërsa pas kësaj takimi vazhdoi deri në mesnatë me vallzime në bregun me rërë dhe nën dritën e hënës. Të nesërmen paradite, shetitëm edhe një herë bregdetin, folëm gjatë me njeri tjetrin dhe na erdhi keq që dalngadalë po na vinte çasti i largimit për në atdhe. I premtova Péter Lenkey, se prej këtij do të paguaj pushimet e mija, sepse nuk të krahasuar një përshtypje më e mirë dhe më e madhe se të udhëtosh kështu. U kthym për në atdhe përmes Romës, ku patë pak kohë të vizitonim pak qytetin. Natën mbrritëm në Hungari pak të lodhur, por shumë të lumtur. Faleminderit që munda të merrja pjesë në këtë takim, faleminderit sepse përfitova shumë, faleminderit skuadrës time dhe sponsoret time Edit Móricz, faleminderit Rex-it që endërron gjëra të tilla, dhe që në këto endërra të mund të mirrja pjesë edhe unë.

**Anikó Kardos
Menaxher Senior Eagle**



Drejtesja e programit ishte **Andrea Žantev** eagle menaxhere - inxhinjere e trafikut detar. Në thellësi të shpirtit është sportiste dhe tifoze e madhe e natyrës. Se përse zgjodhi Foreverin pas dhjetë vjet përdorimi të produkteve si vend të ri pune? Andrean përveç cilësis me të vërtetë të jashtzakonshme të produkteve e motivoi përparimi i dy çifteve. Njohu, se si njëherësh mund të punosh dhe të shijosh lirinë, pavarësinë. Nga një biznes i vogël përparoi drejt të madhit: mësoi shumë, dëgjoi sponsorin, ndryshoi, dhe vetëm tani shikon, se për sa më shumë gjëra ka aftësi, nga çfarë e kishte menduar në fillim. Në çdo vit vendos para vetes objektiva më të mëdha.

Drejtori rajonal **dr. László Molnár** bën prezantimin e produkteve të reja, duke theksuar paletin e ri të kozmetikës. Është lajm i mirë, që tashmë antarët e familjes së kozmetikës mund të blihen. Një lavdërim i madh ju përket distributorëve kroatë, të cilët me punën e tyre mundën ta rrisnin xhiron në kohë të vështira.

Është diçka e mirë dhe e që të të qëndrosh përpara një zyre të tillë, që nga muaji në muaj sjell kualifikime të reja! Disa nga bashkëpunorët tanë sapo janë kthyer nga Hawaii, ndërkohë që të tjerët udhëtojnë për në Sardenjë. Programet stimuluese qëndrojnë para nesh, ato vetëm duhen realizuar, pastaj mund të shijojmë shoqërinë e drejtuesve dhe të distributorëve më të suksesshëm. Më të suksesshmit - menaxherët - shpresojmë - që tani po përgatiten për fundjavën e paharrueshme të Istrias, të mbushur me mësim dhe argëtime. Holiday Rally në Opatij nuk është shumë larg. Është akoma e mundshme për tu kualifikuar në këtë mundësi të shkëlqyer mësimi dhe argëtimi! Dr. László Molnár foli me krenari për hapjen e objektit të ri hollandez në 18 maj, të magazinës së re qendrore Forever Direct. Në hapjen dhe festivitetin e madh morrën pjesë të gjithë drejtuesit, nën udhëheqjen e Rex Maughanit.

Dr. Alena Buretić-Tomljanović, është pedagoge në Universitetin e Mjeksisë së Rijekës në Institutin e Biomedicinës. I shoqi, **dr. Draško Tomljanović** është konsulent mjekësor i FLP-s. Alena është autore e më shumë se tridhjetë punimeve shkencore dhe





profesionale. Titulli i leksionit është: "Omega-3, po apo jo?" Në leksionin profesional ja doli mbanë të tregojë, që Omega-3 është me rëndësi jetike për trupin tonë, zemrën, kyçet, për anën e shëndetit shpirtëror dhe shëndetin e lëkurës.

Ivan Lesinger që nga moshë 12 vjeçare merret me bimët medicinale. Ndërkohë gjatë përfundimit të Universitetit të Shkencave të Natyrës të Zagrebit, morri si studim të veçantë edhe trajnimin e Shoqatës së Bimëve Medicinale, dhe që nga 2003-shi jep mësim në Universitetin e Mjeksisë së Rijekës. Është autor i një numri librash. Gjatë viteve futi në punën e tij edhe aloe verën. Titulli i leksionit të tij është: "Aloe vera dhe unë - dy miq të mirë". Nga leksioni fantastik mësuam shumë për historinë e kësaj bime, për efektshmërinë e mekanizmit të saj dhe mënyrat e përdorimit.

Më pas vazhdoi interpretimi i antareve të duetit pop kroat një nga më të suksesshmit për vitet 80 Denis&Denis. Shijam zërin e mrekullueshëm dhe imazhin origjinal, shumë vetë u ngritën edhe në kërcim.

Dubravka Čalušić është shtëpiake dhe menaxhere. Bashkë me të shoqin punojnë në Forever që nga 2001. Bashkëshorti, **Ante** përdor të gjitha produktet e Foreverit. Ai thotë për veten, se pa produktet ndryshe do të ishte cilësia e jetës. Dubravka është mamaja e gjashtë fëmijëve dhe gjithë nënë të nipërve e mbesave. Krahas detyrave të shumta, u bë menaxhere për një vit e gjysëm. Ndonëse vjen nga një krahinë, ku varfëria është e madhe dhe ka pak para, prapë shumë persona duke ndjekur rekomandimet e saj i blejnë produktet. Ky tani është një rast ideal - e shpjegon Dubravka.

Tregon, se si filloi, me çfarë vështirësish u takua, se si e befasuan bonuset dhe se si i stimuluan njerëzit për të ecur përpara. Që të arrijë në kohë në të gjitha prezantimet, se si e dha provimin në moshën pesëdhjetë e tre vjeçare për marrjen e patentës. Objektiv i saj është që të arrijë deri në fund të periudhës së kualifikimit për Holiday Rally pozicionin e senior menaxheres. Jemi të sigurt që do t'ja dali me sukses!

Lektori i rradhës erdhi nga Velika Gorica. Sipas fjalëve të **Danijel Štajdohar** ai ka punuar shumë gjatë gjithë jetës. Për atë nuk është e huaj sipërmarrja private, e shoqja ka një sallon parukerie, ndërsa ai është drejtues i fluturimeve. Ndonëse në vend tjetër nuk mundi të ndërtoj biznes të madh, kur u njoh me Foreverin, u nis me energji të mëdha me atë vendim, që të bëhet sa më parë menaxher dhe të zgjeroi biznesin në të gjithë botën. Seriozitetin e vërtetojnë edhe rezultatet e tij. Këtë vit filloi punën, dhe u bë supervisor gjatë periudhës parapërgatitore të kësaj Dite Suksesi, në muajin e fundit u bë assistant menaxher, dhe së shpejti do të jetë menaxher. Nga vetë ai e dimë, se si duhet përparuar nga muaji në muaj në interes të suksesit. Dhe që të gjithë këtë ta bëj realitet, Danijeli ka një mënyrë të vetën: vendos objektiva, flet me njerëz, përvetëson lëndën mësimore, mëson çdo gjë për produktet, për planin e marketingut, për të qënë 100% konsumator dhe për të mos nënvleftësuar aftësitë tona njohëse.

"Nëse do të tregojmë shembullin tonë, atëherë nuk ka nevojë të krijojmë rregulla." - thotë ai.





Kualifikimi i bashkpuntorëve tanë më të suksesshëm ishte jashtzakonisht solemn. Në podium të kualifikuarit, sponsorat e tyre, bashkpuntorët e tyre ndrronin njëri-tjetrin - secili uronte secilin. Fotografime, mirënjohje, premtime, dy-tre pika lot gëzimi. Urojmë të kualifikuarit dhe grupet e tyre!

Sanja Balen, është ekonomiste, mësuese në një shkollë të mesme ekonomike, ku jep disa lëndë të zanatit, midis të tjerave edhe njohuri mbi sipërmarrjet. I pëlqen shumë numrat, të cilat e kanë ndihmuar me siguri në ecjen përpara. Dhe si u fut në Forever duke qënë mësuese? Me nënën e një prej nxënësve me kalimin e kohës u miqësua aq shumë, sa Sonja së fundi u bë bashkpuntorja e saj në Forever. Në Forever ka demonstruar gjithmonë vendosmëri të madhe dhe aftësi për punë. Ka vendosmëri, dhe është një nga ato të paktët, që pas dy vjet lënie ia doli mbanë që nga assistant menaxhere të bëhet menaxhere. Që çfarë kërkon e gjithë kjo? Për këtë foli në leksionin e saj.

Boris Vlastelić është i martuar, ka një djalë dhe është gjyshi i dy nipërve. Që në moshë rinore ka qënë i gatshëm për të punuar shumë, por tregoi edhe atë: që ka aftësi për ndrrime të mprehta që ai dhe familja e tij të kenë shanse më të mira. Ishte detar, sipërmarrës privat, së fundi u dashurua me Foreverin. Pas gjysëm viti punë u bë menaxher. Nga leksioni i tij i thjeshtë, me zemër të hapur dhe i sinqertë mundëm të mësojmë, përse dhe kur vendosi pranë Foreverit. Borisi na mëson: kurrë nuk është vonë për të filluar, me ndihmën dhe përkrahjen e sponsorit mund të ndryshosh jetën tënde dhe të familjes tënde.

Jadranka dhe Nenad Pavletić janë besnik të Foreverit që nga 1999. Përpara tij nuk kanë punuar kurrë në MLM. Jadranka ishte ajo, që filloi dhe ishte e gatshme për të mësuar. Lexoi shumë libra, morri pjesë në shumë trajnime. Në fillim punoi vetë, më pas u lidh me të edhe i shoqi. Sot janë senior menaxherë, fitues të programit për makinën, të tretët në rajon për pikët e jo menaxherit duke llogaritur edhe pikët e tyre. 2012 ishte vit jashtzakonisht i suksesshëm për ata, midis të tjerave u kualifikuan për në Global Rally. Në leksionin e tyre duke përdorur dramaturgjinë e duhur, formuluan udhëtimin fantastik të Hawaiiit. Ata bashkpuntorë që për dy muaj të njëpasnjëshëm realizuan dy pikë, morrën distinktivët e parë. Shpresojmë, që leksionet e rradhës, të qendrojnë në skenë si të kualifikuar.

Ferencé Tanács dhe Ferenc Tanács senior menaxherë në fillim nuk donin të ndërtonin rrjetin. Por m.q.s. kurrë nuk jua lëshuan duart atyre, që në Ditën e Suksesit të rradhës, të qendrojnë në skenë si të kualifikuar.

Ferencé Tanács dhe Ferenc Tanács senior menaxherë në fillim nuk donin të ndërtonin rrjetin. Por m.q.s. kurrë nuk jua lëshuan duart bashkpuntorëve të tyre, më tej janë njerëz të tillë, që nuk ju shmangen problemeve, por i zgjidhin ato, nuk kanë frikë të marrin vendime - e mësuan mësimin dhe sot prandaj janë këtu, që të ndajnë me ne eksperiencën e tyre të pasur. Vjet kanë qënë top distributorë të rajonit duke u nisur nga pikët e tyre dhe të jo menaxherit. Me leksionin e tyre na mësuam: se me çfarë problemesh mund të ndeshemi gjatë sfidës, më tej çfarë duhet të bëjmë "me njerëzit e vështirë". Sekretet se si mund të bëhesh i suksesshëm i transmetuan pa egoizëm. Këshilla e tyre është kjo: "Përfundojeni këtë punë në çift, dhe edhe bashkpuntorët tuaj nxitini, që të punojnë si çift! Ky është biznes familjarë, dhe nëse punojmë së bashku, edhe rezultatet do të jenë më të mira."

Falenderime për të gjithë ata, që me praninë e tyre e bënë më festive Ditën tonë të Suksesit. Ju urojmë shumë sukses në punën tuaj! Dita e Suksesit që do të pasojë, do të jetë në festën e 14 vjetorit të ditëlindjes së FLP-s së Kroacisë në 19 tetor 2013. Vendngjarja do të jetë po ajo - Hotel Adriatic, Opatijë.

Dr. László Molnár, Drejtori rajonal i FLP Kroaci



AMENDIME TË POLITIKËS NDËRKOMBETARE TË BIZNESIT

6. BONUSI I DREJTUESIT (BD)

6.05 (b) Një menaxher i pranuar që ka humbur të drejtën për bonus drejtuesi, mund ta rifitojë këtë të drejtë duke plotësuar kërkesat e mëposhtme:

1) Të realizojë një totale prej 12 pikësh presonale dhe jo-menaxheriale brënda vendit çdo muaj për një periudhë 3 muaj radhazi. (edhe sikur të mos ketë menaxher në linjën e poshtme)

8.04 Statusi Eagle Menaxher:

(a) Statusi Eagle Menaxher fitohet dhe rinovohet çdo vit duke plotësuar kërkesat e mëposhtme gjatë periudhës të kualifikimit që zgjat nga Maji deri në Prill, pas kualifikimit si menaxher i pranuar:

1) Të jetë aktiv dhe të jetë i kualifikuar për Bonusin e Drejtuesit për çdo muaj. (edhe sikur të mos ketë menaxher në linjën e poshtme)

II CHAIRMAN'S BONUS

11.01 (a) Kërkesat bazë për çdo nivel

2) Gjatë periudhës së dhënë duhet të jetë i kualifikuar për Bonusin e Drejtuesit për çdo muaj (edhe sikur të mos ketë menaxher në linjën e poshtme) ose në qoftë se kualifikohet Menaxher i Nohur gjatë periudhës së dhënë, pas kësaj çdo muaj duhet të kualifikohet për Bonusin e Drejtuesit (edhe sikur të mos ketë menaxher në linjën e poshtme)

4) Të drejtën përfundimtare për pjesmarrje në Programin e Chairman's Bonus e jep Komisioni Ekzekutiv duke patur parasysh çdo dispozitë të Politikës të Biznesit, duke përfshirë, por jo vetëm, dispozitat e paragrafit 16.02 të Politikës të Biznesit.

Menaxherët e Nivelit të I-rë, II-të dhe të III-të të Chairman's Bonus:

Në qoftë se një distributor arrin Nivelin e Menaxherit gjatë periudhës të kualifikimit, çdo distributor të ri që e ka sponsorizuar në muajin e fundit të ngjytjes, pikët e tij llogariten si pikë të reja për periudhën e kualifikimit për Chairman's Bonus.

[shënim i redaksisë:kushtet e përshkuara në paragrafin e mësipërm plotësojnë listën e kushteve për të tre nivelet që lidhen me sigurimin e nivelit të Menaxherit të Chairman Bonus.]

18.02 Të drejtat ligjore të distributorit pas vdekjes të tij

5) E drejta e njohjes të distributorit të trashëguar brënda Planit të Marketingut të Kompanisë kufizohet në njohjen jo më lart se niveli i Menaxherit. Megjithatë bonuset do të paguhen në të njetin nivel dhe me ato kërkesa që kishte për të ndjerin. Të gjithë Menaxherët e Sponsorizuar që i përkasin Distribucionit, do të riklasifikohen si Menaxher të Trashëguar, që më vonë të kualifikohen si Menaxher i Sponsorizuar sikurse përshkruhet në Paragrafin 5.04(e). Pozicioni i distribucionit poshtë nivelit të Menaxherit do të trashëgohet në atë nivel

„FORCA E FOREVERIT QËNDRON TEK FORCA E DASHURISË”



Gjatë zhvillimit të Trainimit të II-të Të Diamantëve nën kujdesin e Miklós Berkics, Hungaria luftonte me përmytjen nga shirat, Danubi arriti në Budapest nivelin më të lartë historik. Forca të mbrojtjes nga katastrofat, ushtarë e civila, përforconin ditë e natë digat penguese. Punën e tyre plot sakrificë e ndihmuan edhe pjesmarrësit në trainim me donacionet e mëposhtme:

Ujë mineral Sirona 3978 copë

Pije energjike FAB 580 copë

Pije energjike FAB X 312 copë

Dizifektant duarsh Forever Hand Sanitizer 1235 copë

Çokollata Fast Break 1743 copë

Detergjent Forever Aloe MPD2X 99 copë

Aloe First 12 copë

Aloe Sunscreen 30 copë

Donacionet e mbledhura ia dorëzoi Drejtorisë të Mbrojtjes nga Katastrofat, në bazën e stërvitjes të saj në Budapest, vetë Drejtori i Përgjithshëm i FLP të Hungarisë Dr. Sándor Milesz.



NË MBARË BOTËN SIVJET FESTOHET 35 VJETORI I FIRMËS FOREVER. JEMI KRENAR, QË MUNDËM TË JEMI PJESE E NJË FIRMETË TILLË TË FUQISHME E GLOBALE. ISHTE KËNAQSI QË EDHE DITA E SUKSESTIT NË BEOGRAD PËRKONTE ME KËTË NGJARJETË SHËNUAR.

BEOGRAD, 19.05.2013.

Success Day

Drejtues të programit ishin **Dr. Dušanka Tumbas**, dhe sponsori saj **Siniša Blašković** – senior menaxherë. Të dy janë

shembull i gjallë i punës në grup dhe i ndjekjes me këmbëngulje të planit të marketingut, por ajo që është më e rëndësishme: ata janë FOREVERA, domethënë miq të përjetshëm! Ju faleminderit atyre që e bënë të paharrueshëm këtë festim jubilar.

Drejtuesi i FLP Serbi, **Dr. Branislav Rajić** na tregoi me fakte se vetëm cilësia mund të mbetet kaq gjatë në botë, si dhe për atë që në Hungari dhe rajonin që ajo mbulon synohet që nga firma të marrim gjithshka është e mundur. Pikërisht kjo ka qënë për 35 vjet në Forever, dhe këto rezultate vazhdojnë edhe sot!

Foreveri është globalizuar, në vend të takimeve të veçanta kontinentale, tani zhvillohet takimi i përmasave botërore Forever Global Rally, që sivjet u zhvillua në parajsën e ishujve Hawaii. Atmosferën e paharrueshme të këtij Global Rally na i sollën **Miloš Janović** – senior menaxher, **Boško Buruš** – zafir menaxher dhe **Stevan Lomjanski** – diamant menaxher. Takohemi në Londër në Global Rally-n e ardhshëm!





Parakusht për një ecuri të sukseshme të biznesit janë produktet cilësore. Dhe për këtë na flasin distributorët që përdorin përditë produktet e FLP, si dhe mjekët me përvojën e siguruar gjatë punës së tyre. Faleminderit **Dr. Marija Rakrovićit**, mjekes së parë në Europë si zafir menaxhere, për punën e përkushtuar shumëvjeçare!

Nga podiumi i Shtëpisë të Sindikatave, falnderuam supervizorët e asistent menaxherët e sapo kualifikuar, si dhe menaxherët **Ildik dhe Rudolf Molnár**. Ky çift ndoqi me disiplinë rregullat e biznesit MLM dhe si rezultat i punës të skuadrës së tyre arritën nivelin e menaxherit, ndërkohë që plotësuan një numer programesh stimulues të firmës. Kjo është garanci e asaj, se si mund të shfrytëzohen të gjitha mundësitë e ofruara bujarisht nga firma Forever!

FLP e Serbisë mori pjesë në Forever Global Dance – në projektin e valleve mbarë botërore të Foreverit. Nga kjo mundëm të shikonim koreografinë e një grupi të distributorëve të Serbisë si dhe nga grupi valleve Simyonov të Beogradit. Pas kësaj skena e Beogradit u mbush me një energji të paparë kur u shfaqën pjestarët e grupit të valleve USB të Nishit. Me akrobacitë e rrezikshme na bënë të na ndalej frymëmarrja, por nëpërmjet kësaj kuptuam se nëpërmjet praktikës, rezistencës dhe përkushtimit mund të arrish atje ku dëshiron, në majat më të larta.

Distributorët më të sukseshëm, u kualifikuan për Klubin e Conquistadorëve si dhe 60+CC, sepse këto kushte i plotësuan mbi 60 vetë. Vënd takimi i Holiday Rally për





bashpunëtorët tanë që kanë avanxuar të paktën një nivel menaxhimi, për sivjet do të jetë perla e Istrias, Opatija.

